

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“NEW HOPE” sh.p.k.

Neni 1

Themelimi

- 1.1 Emri i shoqërisë është “ NEW HOPE ” Sh.p.k. (këtu më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”). Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: “ Rr. Prokop Mima, Ndërtesa 35, Hyrja 30, Ap.8, pranë qendrës Kristal, Tiranë, Shqipëri ”.
- 2.2 Shoqëria mund të themelojë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjerë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

Neni 3

Objekti

- 3.1 Objekti kryesor i Shoqërisë do të jetë:
 - Investimi, projektimi, ndërtimi, vënia në shfrytëzim, administrimi, mirëmbajtja, menaxhimi, operimi i komplekseve turistike, strukturave të



hotelerisë dhe/ose objekteve të tjera turistike. Ndërtimi i objekteve turistike të përhershme dhe sezonale.

- Ofrimi i shërbimeve të hoteleri-turizmit, Bar - Kafe, restorant, shërbim social, catering, tregtim i artikujve të ndryshëm dhe shërbime që lidhen me këto veprimtari; si dhe çdo veprimtari tjetër plotësuese, që lidhet direkt ose indirekt me veprimtarinë e sipërpërmendur.
 - Prodhim, përpunim, tregtim, degustim, ekspozim dhe shitje e verës, pijeve alkolike, të prodhuar lokalisht brenda ambienteve të kantinës së Shoqërisë.
 - Agroturizëm, shitje produktesh bujqësore dhe organizim aktiviteteve agroturistike. Zhvillimi i udhëtimeve turistike dhe shitja e paketave turistike.
 - Menaxhimi i pronave të veta dhe private për klientë të huaj dhe vendas. Shitja, blerja, dhënia me qira e pasurive të paluajtshme.
 - Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose blejë/përfitojë direkt ose indirekt pjesëmarrje, në shoqëri, ndërmarrje, agjenci apo sipërmarrje të tjera, të cilat kanë fushë veprimtarie të ngjashme.
 - Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme, të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të Shoqërisë, si dhe të ushtrojë çdo aktivitet tjetër të lejuar nga legjislacioni shqiptar.
- 3.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.
- 3.3 Kryerja e aktiviteteve, për të cilat nevojiten lejet dhe/ose miratimet përkatëse, do të bëhet pas marrjes së këtyre lejeve dhe/ose miratimeve.

Neni 4

Kohëzgjatja



- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortaku i Vetëm

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1,300,000 (një milion e treqind mijë) Lekë.
- 5.2 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, zotërues i 1 (një) kuote, të barabartë me 1,300,000 (një milion e treqind mijë) Lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit është:
- **Z. Përparim Ruko**, shtetas Shqiptar, lindur më 20.04.1972, në Roskovec, Shqipëri, banues në adresën: Blvd. Bajram Curri, Godina ETC 5/2, Tiranë, Shqipëri, 1010, mbajtës i Letërnjoftimit me nr.033802412, dhe nr. Personal H20420031M, zotërues i 1 (një) kuote, të barabartë me 1,300,000 (një milion e treqind mijë) Lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit;
- 5.3 Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku i Vetëm pasi të regjistrohet Shoqëria në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe të pajiset me Certifikatën e Regjistrimit.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakut të Vetëm shtrihet deri në shumën e kontributit të vet në kapitalin themeltar.

Neni 6

Ortaku i Vetëm

- 6.1 Ortaku i Vetëm është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.
- 6.2 Ortaku i Vetëm ka funksionet e mëposhtme:
- Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre të fundit nga administratorët.
 - Emëron dhe shkarkon administratorët.



- Emëron dhe shkarkon ekspertin (et) kontabël dhe/ose likuiduesin (t) e Shoqërisë.
- Përcakton shpërblimin e administratorëve, ekspertëve kontabël dhe likuiduesve.
- Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratorët.
- Merr vendim për ndryshimet e këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit.
- Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.
- Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve, dividendëve.
- Merr vendim për ristrukturimin e Shoqërisë ose prishjen e saj.
- Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji.

Neni 7

Administratori

- 7.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator, i emëruar nga Ortaku i Vetëm.
- 7.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:
- **Z. Përparim Ruko**, shtetas Shqiptar, lindur më 20.04.1972, në Roskovec, Shqipëri, banues në adresën: Blvd. Bajram Curri, Godina ETC 5/2, Tiranë, Shqipëri, 1010, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 033802412, dhe nr. Personal H20420031M;
- 7.3 Mandati i administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Ortakut të Vetëm në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 7.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori.



Neni 8

Viti Financiar

- 8.1 Viti financiar fillon në 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 8.2 Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2022.

Neni 9

Të ndryshme

- 9.1 Ky Akt Themelimi është nënshkruar në 3 (tre) kopje origjinale në shqip.

ORTAKU I VETËM

Për "NEW HOPE" Sh.p.k

z. Perparim Ruko



Tiranë më 30.08.2022